



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr.413, datë 20.12.2021

**PËR CAKTIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË  
NË BORDIN DREJTUES TË QENDRËS SË TEKNOLOGJISË SË  
INFORMACIONIT PËR SISTEMIN E DREJTËSISË**

Bazuar në nenet 92, 159 dhe 189, të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pikat 9/b dhe 27, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020, “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I :**

1. Të caktojë Z. Alfred Balla, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si anëtar me të drejtë vote në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.
2. Anëtari i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është zëvendëskryetar i Bordit Drejtues.
3. Anëtari i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron të gjitha kompetencat e kryetarit të Bordit Drejtues, në mungesë dhe pamundësi të këtij të fundit.
4. Të njoftohet për këtë vendim Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

